



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirilli dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup  
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 [www.kzk.gov.mk](http://www.kzk.gov.mk) e-mail: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk)



Njoftimi i përqendrimit me të cilin Mosburger GmbH Austri do të fiton kontrollin mbi punën e prodhimit të tablove dhe ambalazheve të kartonit për kontejner në fabrikën Eskeseish të Grupit Shishexham

(lënda nr. 08-46/2016)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta Zyrtare nr. 145 / 10, 136/11 dhe 41/14), me datën 15.09.2016, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës merr njoftimin e përqendrimit në lidhje me marrjen e kontrollit të vetëm nga Mosburger GmbH me seli në Ketzergase 112, A- 1232 Vjenë, Republika e Austrisë, mbi punën e prodhimit të tablove dhe ambalazheve të kartonit për kontejner („objektivi i punës”) i cili do të transferohet në kompaninë të sapo themeluar, me seli në Mymtaz bulevardi Zejtinogly, Organize Sanaji Bolgesi, 26110 Eskeseish- Turqi, nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve në Kompaninë, nga kompanitë Turkie Shishe ve Xham Fabrikalere A.D. dhe Pashabahçe Xham Sanaji Ve Tixharet A.D., të dy kompanitë me seli në Shishexham Genel Merkezi İçmeler Maxh. D100 Karajoulu Xhadesi, nr. 44A 34947, Tuzlla Istambull, Turqi (në tekstin e mëtutjeshëm së bashku si: „Shitësit” dhe individualisht si: „Shitës”). Shitësit i takojnë grupit të njëjtë të kompanive, i ashtuquajtur Grupi Shishexham (Shishexham Group”), me Pashabahçe xham Sanaji Ve Tixharet A.D. si filiale e kompanisë së Turkie Shishe ve Xham Fabrikalere A.D.

Mosburger GmbH i takon Grupit të Princhorntë të kompanive. Si një Grup në pronësi familjare me seli në afërsi të Vjenës (Republika e Austrisë), Grupi Princhorntë është strukturuar në tri divizione:

- Hamburger Grupi i riciklimit (Hamburger Recycling Group) (mbledhjen dhe tregtimin e lëndëve të para);
- Hamburger Material për kontejner (Hamburger Containerboard) (prodhimin e materialeve të kartonit për kontejner (anglisht: *containerboard*));
- Dunapak Paketimet (Dunapack Packaging) ( zgjidhje për paketim – ambalazhe të kartonit për kontejner).

Princhorntë Holding është një kompani strategjike e Grupit Princhorntë, me 45 të punësuar të cilët janë përgjegjës për zhvillimin e ardhshëm të biznesit në Grupin.

Mosburger i takon njësisë së biznesit të Dunapak Paketimeve. Mosburger prodhon tablo dhe ambalazhe prej kartonit për kontejner, kjo e fundit me të gjitha materialet standarde për ambalazhim. Tablat e kartonit për kontejner janë produkte natyrale, ekologjikisht i pranueshëm, ekonomik 100% i përshtatshëm për riciklim. Mosburger ofron produkte me standard të lartë të kualitetit dhe zhvillon zgjidhje të përshtatura të paketimit për kërkesat individuale të klientëve.

Princhorntë grupi nuk ka filiale të regjistruara në Republikën e Maqedonisë, por në vitin 2015, nëpërmjet filialit të tij në Republikën e Bullgarisë ka realizuar shitjen e paketave të disa kompanive nga Republika e Maqedonisë.



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54 (kati i 6), 1000 Shkup  
Tel (02) 3298 666 Faksi (02) 3296 466 [www.kzk.gov.mk](http://www.kzk.gov.mk) e-mail: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk)



**„Objektivi i punës”** ka të bëjë me prodhimin e tablove dhe ambalazheve të kartonit për kontejner në fabrikën Eskeseish të Grupit Shishexham i cili aktualisht është në pronësi të Shitësve nëpërmjet filialit Xhamis Ambalazh Sanaji A.D., me seli në adresën Istasion Max. Sehitler Xhad. Nr. 139 Tuzla, Istambull, Turqi. Shitësit posedojnë 100% të aksioneve në Xhamis. „Objektivi i punës” nuk është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë.

Pas zbatimit të transaksionit, Grupi Princhorh do të fiton kontroll të pavarur mbi „Objektivin e punës”, në pajtim me Marrëveshjen për shitblerjen e aksioneve.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu relevant i produkteve për përqendrimin i cili është në shqyrtim do të mund të përkufizohet ose si një treg i shitjeve me shumicë i zgjidhjeve për paketim i kartonit për kontejner (si një treg me i gjerë relevant) ose mund të bëhet një ndarje e mëtejme për tregjet më të ngushta edhe atë me tablo prej kartoni për kontejner, në njërin anë, dhe në anën tjetër ambalazhim prej kartoni për kontejner. Tregu relevant gjeografik mund të përkufizohet si territori i Republikës së Maqedonisë.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak Komisioni konstaton se përqendrimi në shqyrtim mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi 54, Shkup ose me email: [kzk@kzk.gov.mk](mailto:kzk@kzk.gov.mk) dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

19.09.2016  
Shkup